

Fitim RIFATI

Rëndësia historike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Ekspansioni dhe gjenocidi shtetëror serb ndaj shqiptarëve e viseve të tyre mori formë zyrtare në vitin 1844 me platformën “Naçertania” (“Projekti”) të Ilia Garashaninit. Gjatë Luftës Ruse-Osmane të viteve 1877-1878 dhe luftërave ballkanike (1912-1913), ky program po realizohej konkretisht.¹ Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1912-1913) me vendimet e saj dëmtoi rëndë shqiptarët dhe tokat e tyre. Kosova dhe vise të tjera shqiptare iu ndanë mbretërive ballkanike të Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi.²

Mirëpo, ideali i lirisë, çlirimit dhe bashkimit kombëtar vazhdoi të mbetet aspiratë e forcave progresiste shqiptare me perspektivë kombëtare. Që nga ajo kohë në skenën politike shqiptare, sikurse në viset e pushtuara, u paraqitën forca e rryma, të cilat për qëllim kishin çlirimin dhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve. Në këtë vazhdë, padyshim, në dekadën e fundit të shekullit XX, vend meritore u paraqitja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që kishte për synim të fundit çlirimin dhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve.³

¹*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2002, f. 102-103, 139-153, 501-508.

²*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 18-27.

³ Izber Hoti, *Në udhëkryqet e historisë dhe historiografisë shqiptare*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2003, f. 100; Jakup Krasniqi, *Guxo ta duash lirinë*, Prishtinë: “Buzuku”, 2011, f. 13.

Ajo ishte forcë e organizuar ushtarako-politike me karakter dhe fizionomi mbarëkombëtare, që për qëllim pati çlirimin e Kosovës nga pushteti arbitrar, ushtarako-policor e violent serbo-jugosllav, i cili eliminonte çdo lëvizje atdhetare përmes metodave të dhunës psiko-fizike deri te asgjësimi etnik.⁴

UÇK, e cila publikisht veproi në vitet 1997-1999⁵, ishte forcë e restauruar, produkt konvergjent i gjeneratave të tëra dhe i një plejade atdhetarësh nga profile të ndryshme në simetri dhe lidhje organike me forca të tjera kombëtare në periudha të ndryshme të historisë së popullit shqiptar. Ajo ishte manifestim i vullnetit metafizik të një populli të aftë, fisnik dhe liridashës, e cila bëri jehonë te ky popull dhe nga përmasat ballkanike, evropiane dhe botërore grumbulloi e mobilizoi në radhët e saj bijtë dhe bijat më të mira, më të besueshëm, më të devotshëm, me ndërgjegje kombëtare e ndjenja atdhetare, që paepur luftuan denjësisht dhe me entuziazëm homogjen vunë jetën e tyre në altarin e lirisë.⁶

Me kompaktësinë e forcave materiale dhe morale, UÇK e ushtroi aktivitetin e saj në etapa të shkallëzuara, duke e ekspozuar atë nga materializimi i idesë së luftës së armatosur, sensibilizimi i ndërgjegjes kombëtare në nivel të përgjegjësisë historike, fillimi i atentateve

⁴ J. Krasniqi, *Guxo...*, f.17-24.

⁵ *Po aty*, f.15-16; Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Prishtinë: “Koha”, 2011, f. 22.

⁶ Gjeneral Agim Çeku, “Roli i UÇK-së në çlirimin e Kosovës”, *Kosova*, revistë historike/politike, nr.8/2000, f. 31-32; Grup autorësh, *Feniksët e lirisë - dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, Vëllimi 1-17, Prishtinë: Shoqata e Veteranëve të Luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 2002-2018; I. Hoti, *Në udhëkryqet...*, f. 96-98; Emin Kabashi, *Batalioni “Atlantiku” i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, Prishtinë: “Çlirimi”, 2004; Jakup Krasniqi, *Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991 sipas shtypit shqiptar*, Prishtinë: “Buzuku”, 2006, f. 7-260; Kolonel Hajrush Kurtaj, *Në rrugën e lirisë: (ditar luftime: fakte, kujtime, dokumente)*, Prishtinë: “Qendra”, 2011.

sporadike kundër stacioneve dhe policisë serbo-jugosllave, formimi i njësiteve të vogla guerile, krijimi i reparteve të organizuara, brigadave, shtabit të përgjithshëm, drejtorisë politike dhe funksionimi i shtatë zonave operative.⁷

Historia e UÇK-së tregoi se pengesa kryesore për çlirimin e Kosovës nuk vinte vetëm nga Serbia, por edhe nga qëndrimi i faktorit ndërkombëtar, i cili kishte disponim për të ruajtur status quo-në. UÇK provoi gjithashtu se brenda vendit realizimi i programit të saj mbështetjen politike, morale, materiale e luftarake duhej ta kërkonte tek shtresat e gjera të popullit dhe te bashkimi i të gjitha forcave shoqërore e politike. Shqiptarët u bindën se luftën çlirimtare duhej ta zhvillonin duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e tyre njerëzore e materiale dhe se duhej të punonin njëkohësisht për të siguruar përkrahjen e Fuqive të Mëdha më demokratike të botës, sidomos të atyre që kishin filluar të anonin në zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës, siç ishin: SHBA-ja dhe aleatët e saj evropianë.⁸

UÇK dhe lufta e saj e drejtë provuan para faktorit ndërkombëtar se populli shqiptar është i gatshëm të mbrojë trungun e tij dhe të sakrifikojë gjithçka vetëm të frymojë dhe zhvillohet i lirë në territorin e vet. Në këtë kontekst, shembulli më konkret, ndër rastet fenomen në historinë më të re të njerëzimit, ishte lufta dhe rënia heroike e drejtuesit të UÇK-së, Adem Jashari dhe familjes së tij në Prekaz⁹, ndërsa në

⁷*Po aty*, f. 34-35; J. Krasniqi, *Guxo...*, f. 15; James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës - nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Tiranë: “Onufri”, 2013, f. 92-103.

⁸*Po aty*; J. Krasniqi, *Guxo...*, f. 24.

⁹ Besarta, e vetmja anëtare e familjes Jashari, që i kishte shpëtuar luftës së Prekazit kundër forcave ushtarake e policore serbe, më pas kishte deklaruar: “*Axha Adem po u jepte zemër bashkëluftëtarëve të tij me një këngë të moçme trimërie*”. Në luftën e

skenën e gjenocidit me masakrën e Reçakut¹⁰dhe shumë masakra të tjera, u thye teza se shqiptarët do të mund të ekzistonin dhe jetonin të bashkuar dhe të dakorduar me aparatin shtetëror serbo-jugosllav, i cili zbatonte aparteid ndaj popullit shqiptar në të gjitha fushat e jetës. Prandaj, UÇK reflektoi në thyerjen e antinomisë së organeve vendimmarrëse të faktorit ndërkombëtar dhe lëvizi mekanizmin diplomatik të tyre, duke demaskuar politikën e prepotencës, represionit, brutalitetit psiko-fizik, vrasjeve masive, kulturocidit deri në gjenocidin sistematik që pushteti serbo-jugosllav ushtroi ndaj shqiptarëve të Kosovës, duke shërbyer kështu si argument dhe arsyetim para faktorit ndërkombëtar për të intervenuar ushtarakisht kundër forcave serbo-jugosllave.¹¹

Prekazit u vranë mbi 50 anëtarë të lagjes së Jasharajve. Shih: Ramiz Abdyli, Adem Jashari (1955-1998), *Kosova*, revistë historike/politike, nr.8/2000, f. 29-30; Grup autorësh, *Feniksët e lirisë - dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*, vëllimi i dytë, Prishtinë: Shoqata e Veteranëve të Luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 2002, f. 9-17; Jakup Krasniqi, *Flijimi për lirinë*, Prishtinë: “Buzuku”, 2011, f.76-81, 89-93.

¹⁰ Shih më gjerësisht: Grup autorësh, *Masakra e Reçakut krim kundër njerëzimit*, Shtime: Fondi i Kompleksit Përkujtimor Masakra e Reçakut, 2004; Bardhyl Mahmuti, *Mashtrimi i madh*, Tiranë: “Çabej”, 2015, f. 75-162. Ambasadori William G. Walker, lidhur me masakrën e Reçakut, në mes tjerash kishte deklaruar: “...Masa e zënë robër, burra dhe djelmoha, ishin vranë me gjakftohtësi, në kundërshtim me rregullat e luftës dhe moralin njerëzor”. Shih për këtë: Ambasadori William G. Walker, “Kujtimet e mia për Reçakun”, *Kosova*, revistë historike/politike, nr.8/2000, f. 21; Hajrush Kurtaj, *Lufta e UÇK-së në ZON*, Prishtinë: “Qendra”, 2012, f. 79-85.

¹¹ Human Rights Watch, *Nën pushtetin e urdhrave: Krimet e luftës në Kosovë*, Tiranë: “Korbi”, 2002; Grup autorësh, *Krimet e Luftës në Kosovë: 1998-1999*, Prishtinë: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNI), 2010; J. Krasniqi, *Flijimi...*, f.86-87; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë: 1998-1999*, Libri 1 dhe 2, Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012; N. Malcolm, *Kosova...*, f. 24-33; Oliver Jens Schmitt, *Kosova - histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë: “Koha”, 2012, f. 261; Fetnete Ramosaj, *Kundër*

Në arenën e luftës, pavarësisht dallimeve në arsenalin e armëve dhe numrit të ushtarëve, UÇK dha rezultate në përballje kundër ushtrisë dhe policisë serbo-jugosllave në Kosovë, e gozhdoi dhe sfidoi atë në beteja, por pati edhe humbje të ndjeshme në luftëtarë, civilë të ekzekutuar dhe mijëra të zhdukur.¹²Ndonëse ishte e vetmja forcë që mbrojti dhe u kujdes për popullsinë e pambrojtur, siç shprehej në atë kohë presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Clinton “*NATO dhe UÇK bënë që Millosheviqi të nënshtrohet*”.¹³Prandaj, në kushtet dhe rrethanat rënduese në të cilat veproi UÇK, lufta për çlirimin e Kosovës nuk mund të mbështetej veçse në forcat e saj dhe nuk mund

harresës: gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998-1999, Prishtinë: Instituti për Kërkimin e Krimeve të Luftës, 2017; Fejaz Drançolli, *Trashëgimi e shkatërruar në Kosovë 1998/99*, Prishtinë: Instituti për Kërkimin e Krimeve të Luftës, 2017; Baki Svirca, *Plaçkitja dhe shkatërrimi i Fondit Arkivor të Kosovës nga Serbia, para dhe gjatë luftës 1998-1999*, Prishtinë: Instituti për Kërkimin e Krimeve të Luftës, 2017; Steven Pearlstein, “NATO Admits Bombing Kosovo Rebels”, *Washington Post Foreign Service*, Sunday, May 23, 1999; Page A27, qasur më 21.01.2019, <http://www.washingtonpost.com/wp-srv/inatl/longterm/balkans/stories/nato052399.htm?noredirect=on>; Human Rights Watch, *Kosovo: Civilian Deaths in the NATO Air Campaign*, 1 February 2000, D1201, qasur më 19.01.2019, <https://www.refworld.org/docid/3ae6a86b0.html>.

¹² Press Conference by Mr Jamie Shea, NATO Spokesman and Major General Walter Jertz, SHAPE, NATO HQ, Brussels, 2 June 1999, qasur më 17.01.2019, <https://www.nato.int/kosovo/press/p990602a.htm>; I. Hoti, *Në udhëkryqet...*, f. 99-100.

¹³ Paul E. Gallis, *Kosovo: Lessons Learned from Operation Allied Force*, Washington: CRS Report for Congress - Received through the CRS Web, November 19, 1999; Bill Clinton “Ne fituam...”, *Kosova*, revistë historike/ politike, nr.8 /2000, f. 7.

t'ia arrinte qëllimit e vetëm, por me intervenimin e NATO-s, realizimi i këtij qëllimi u bë realitet.¹⁴

Absurdi teorik për të klasifikuar dhe quajtur “konflikt” luftën në Kosovë gjatë viteve 1997-1999, konsiderojmë se është tendencë për të parcalizuar dhe për t'i dhënë karakter fiktiv e diskreditues luftës së drejtë të UÇK-së. Në përputhje me të gjitha konditat dhe kushtet shkencore e historike për një dukuri të tillë, vlerësojmë se ajo ishte një luftë e pamohueshme.¹⁵

Për sa më sipër, mund të përfundojmë se rëndësia historike e UÇK-së qëndron në faktin se:

1. UÇK lindi dhe u formua si ushtri e popullit nga gjiri i forcave atdhetare, politike e përparimtare shqiptare, brenda e jashtë Kosovës.¹⁶

2. Ajo bëri që SHBA-ja me aleatët evropianë, të fitojnë besimin dhe bashkëpunimin e saj në luftën e drejtë për çlirimin e Kosovës.¹⁷

3. UÇK dhe çlirimi i Kosovës shënojnë një ngjarje me rëndësi jetike për popullin shqiptar, sepse mbyllën një epokë luftërash e

¹⁴ Jakup Krasniqi, *Pavarësia si kompromis*, Prishtinë: “Buzuku”, 2010, f. 62-63; J. Krasniqi, *Guxo...*, f. 141; Press Conference of NATO Spokesman Jamie Shea and Air Commodore David Wilby, SHAPE, Transcript NATO HQ, 27 Mar. 1999, qasur më 20.01.2019, <https://www.nato.int/kosovo/press/p990327a.htm>; Press Conference by NATO Secretary General, Mr. Javier Solana, NATO HQ, Brussels, 10 June 1999, qasur më 15.01.2019, <https://www.nato.int/kosovo/press/p990610b.htm>.

¹⁵ Izber Hoti, “Paqartësi kuptimore: Konflikt apo luftë”, *Koha DITORE*, Prishtinë, e shtunë, 28 shkurt 2004, f. 27; Izber Hoti, *Orientime dhe qëndrime politike të shqiptarëve në Kosovë*, Prishtinë: “Faik Konica”, 2010, f. 15-23.

¹⁶ Gj. A. Çeku, “Roli...”, f. 33-34; Hasan Hasani, *Të pavdekshmit e Dukagjinit - dëshmorët e UÇK-së të ZOD*, Pejë: “Dukagjini”, 2002, f.7-665; *Në kërkim të dijës dhe të lirisë (Dëshmorët dhe viktimat e Universitetit të Prishtinës 1997-1999)*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2004, f. 11-332; J. Krasniqi, *Guxo...*, f.14-15; J. Krasniqi, *Flijimi...*, f.85; J. Pettifer, *Ushtria...*, f. 81-92.

¹⁷ R. Abdyl, “Adem...”, f. 30.

përpjekjesh shekullore për të hequr qafe zgjedhën serbo-jugosllave dhe për të ruajtur tërësinë territoriale të atdheut.

4. Lufta e drejtë e UÇK-së dhe çlirimi i Kosovës, përfaqësojnë fitoren e përbashkët të të gjitha trevave shqiptare në gjeografinë e Evropës Juglindore dhe të atdhetarëve shqiptarë kudo në botë. Kjo luftë po ashtu i dha shtytje shqiptarëve nën Serbinë e Maqedoninë, që sipas shembullit të Kosovës, të zhvillojnë luftë çlirimtare.¹⁸

5. Si hallkë e fortë në zinxhirin e ngjarjeve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, UÇK shënoi një hap cilësor në farkëtimin dhe avancimin e platformës politike kombëtare shqiptare dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës.¹⁹

6. UÇK hapi një kapitull të ri dhe krijoi premisat që më 17 shkurt të vitit 2008, Kosova të shpallet e pavarur, demokratike dhe të fitojë njohjen e mbështetjen nga shtetet dhe forcat më demokratike të botës.²⁰ Ky akt njëherazi shënon ngjarjen më të madhe në historinë e popullit shqiptar, pas 28 nëntorit të vitit 1912, duke reflektuar në premisa politike themelore për organizimin mbi baza më të përparuara të jetës shtetërore të pavarur të shqiptarëve e popullit të Kosovës dhe për zhvillimin më të shpejtë ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit.

7. Në optikën e platformës së Rilindjes Kombëtare²¹, formimi i shtetit të Kosovës objektivisht ka krijuar premisat për ta mbajtur të gjallë çështjen e çlirimit dhe të bashkimit të të gjitha trevave shqiptare

¹⁸J. Pettifer, *Ushtria...*, f. 259-282.

¹⁹ Shih më gjerësisht: Jakup Krasniqi, *Pavarësia si kompromis*, Prishtinë: “Buzuku”, 2010.

²⁰ Jakup Krasniqi, *Pavarësi dhe personalitete*, Prishtinë: “Buzuku”, 2012, f. 52, 345-352; Listë kronologjike e shteteve që kanë njohur Pavarësinë e Kosovës, qasur më 13.01.2019, <http://www.mfa-ks.net/politika/484/lista-e-njohjeve/484>.

²¹*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, f. 19-31.

dhe për zgjidhjen përfundimtare të problemit shqiptar në Evropën Juglindore, si çështje ende me tipare të një problemi të pazgjidhur evropian.

8. Lufta e UÇK-së ka përçuar një mesazh në politikën botërore se atdhedashuria shqiptare nuk paraqet asgjë shoviniste, ekspansioniste a ksenofobe ndaj popujve e kombeve të tjera, por synon të afirmojë vlera krahas popujve dhe kombeve të përparuara, të plotësojë një detyrë e të drejtë historike kombëtare dhe njëkohësisht të rrojë në paqe dhe fqinjësi të mirë me të gjithë.²²

²² I. Hoti, *Në udhëkryqet...*, f. 101-102; Jakup Krasniqi, *Një luftë ndryshe për Kosovën*, Prishtinë: “Buzuku”, 2007, f. 101-105.